

V E N D I M

Nr. 764, datë 8.12.1998

PËR MËNYRËN E PËRBALLIMIT TË SUBVENCIONIT PËR NDËRMARRJET E UJËSJELLËSIT

Në mbështetje të ligjit nr. 8283, datë 3.2. 1998 “Për buxhetin e shtetit të vitit 1998”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për përballimin e shpenzimeve për subvencionimin e Ndërmarrjes së Ujësjiellës, i shtohet një fond prej 62 556 000 (gjashtëdhjetëdy milionë e pesëqindpesëdhjetëgjashtë mijë) lekë, nga të cilat 5 000 000 (pesë milionë) lekë t’i kalojnë Ndërmarrjes së Ujësjiellës, Durrës, për ruajtjen e stacionit të pompave të Fushë-Kuqes.

2. Efektet financiare, të fondit prej 62 556 000 (gjashtëdhjetëdy milionë e pesëqindpesëdhjetëgjashtë mijë) lekësh, të përballohen nga buxheti i miratuar prej vitit 1998 për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, duke ulur 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë nga shpenzimet e varrimit dhe 49 556 000 (dyzetenëntë milionë e pesëqindpesëdhjetëgjashtë mijë) lekë nga investimet e përealizuara nga buxheti i kësaj ministrie për vitin 1998.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko